

NJOFTIM
Nr. 1546, datë 19.2.2019

PËR SHPALLJE
TË 1 VENDI VAKANT PËR POZICIONIN
SPECIALIST PROTOKOLL/ARKIVË

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e specialistit të protokoll/arkivit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: IV-a.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- a) Të zotërojë diplomë të arsimit të lartë.
- b) Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- c) Të ketë të paktën tre vjet përvojë pune në profesion.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidati duhet të plotësojë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtje penale.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidati duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi.
2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.
3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (originale ose të noterizuar).
4. Dëshmi penaliteti.
5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt.
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda 15 ditëve pas publikimit të njoftimit pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në adresën: “Rruga e Kavajës”, Ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna në të premte, ora 8:30-17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

